



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT
SEKTORI I AUDITIMIT TE BRENDSDHEM

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
ERVIN DEMO

PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR I AUDITIT TE BRENDSDHEM
PER PERIUDHEN 2021 - 2023

Ne kuader te hartimit te Planit Strategjik dhe Vjetor te veprimtarise se auditimit te brendshem, bazuar ne germen c te nenit 14 te ligjit Nr.114/2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik” dhe Kapitullit III te Manualit te Auditit te Brendshem, miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave nr.100, date 25.10.2016 , Ju dergojme nje permbledhje te veprimtarise te Sektorit te Auditimit te Brendshem Publik te Bashkise Berat, Objektivat , Evidencat si dhe Planit Strategjik dhe Vjetor te veprimtarise se Sektorit te Auditimit te brendshem te Bashkise Berat per vitet 2021-2023”

Qëllimi i Planit Strategjik synon:

“Të përcaktojë drejtimit në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e Njesise te AB në sektorin publik të Bashkisë Berat gjatë periudhës për të cilën po hartohet ky plan, kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave duke u bazuar në analizën e riskut për fushat/sistemet të cilat mbulon ky funksion”

Per hartimin e Planit Strategjik të Auditimit per vitet 2021-2023 kemi ndjekur keto faza kryesore:

1. Identifikimi i subjekteve të vartësisë, kohës së auditimit të fundit dhe klasifikimi i tyre sipas statusit.
2. Identifikimi i subjekteve në të cilat kanë ndodhur ndryshime organizative, operacionale ose ligjore të rëndësishme, krahasuar me periudhat e mëparshme.
3. Identifikimi dhe klasifikimi i subjekteve sipas rëndësisë.
4. Njohja me organizaten.
5. Identifikimi i sistemeve dhe fushave llogarise.
6. Grumbullimi i informacioneve
7. Klasifikimi i subjekteve mbi bazën e riskut.
8. Marrja në konsideratë e menaxhimit dhe palëve të tjera të interesuara .
9. Frekuenca e kryerjes së auditimeve.

10. Konsolidimi i punës së planifikimit
11. Përlllogaritja e burimeve të auditimit
12. Hartimi i planit strategjik të auditimit të brendshëm.
13. Miratimi i planit strategjik të auditimit të brendshëm

Planifikimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të auditimit, i cili përcakton se si mund të përdoren më me efektivitet burimet e auditimit, që do të thotë të kuptosh njësinë që do të auditohet, të përcaktosh dhe vlerësosh risqet, të përcaktosh objektivat e auditimit, fushe shtrirjet, kriteret, si dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e auditimit.

Planifikimi është elementi kyç në ciklin e auditimit që siguron suksesin e aktivitetit;

✓ kërkon njohuri dhe kompetencë në një gamë të gjerë fushash që mbulojnë disa tema të rëndësishme si risku dhe kontrollat e brendshme.

☐ do të thotë të kuptosh njësinë që do të auditohet, të përcaktosh dhe vlerësosh risqet, të përcaktosh objektivat e auditimit, fushe shtrirjet, kriteret, si dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e auditimit.

☐ është procesi më i rëndësishëm për disiplinimin e veprimtarisë së AB

☐ i aktiviteteve të AB kryhet për të adresuar elementët e profilit të riskut të organizatës.

☐ përcakton aktivitetin si t'i kryejnë dhe çfarë është e nevojshme të bëjnë për të përmbushur objektivat e auditimit dhe pritshmëritë e palëve të përfshira.

-Vizioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të shtojë vlerën nëpërmjet përmirësimit të operacioneve të subjekteve të audituara duke siguruar përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.

Misioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e bashkise, në mënyrë të pavaruar dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik.

Auditimit të brendshëm i ka dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, duke:

a. Përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;

b. Vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve dhe të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:

i. identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;

ii. përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;

iii. ruajtjen e aseteve;

iv. besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;

v. kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;

vi. përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve.

c. dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike dhe ndjekur zbatimin e tyre.

-Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik është parë nga ana jone si një element planifikimi në arritjen e objektivave të Sektorit të Auditimit për të siguruar se që të gjithë veprimtaritë dhe operacionet e subjekteve publike mbulohen nga funksioni i auditimit të brendshëm duke audituar me shpesh dhe duke i kushtuar vëmendje atyre organizatave që kanë risk me të lartë.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e

nevojave disavjecare për auditime. Frekuencen e auditimit e kemi përcaktuar duke u bazuar në shkallën e riskut që shoqëron këtë funksion gjatë implementimit të tij, numrit të audituesve në njësi si dhe në raste të veçanta sipas gjykimit të drejtimit.

- **Organizimi i NJAB dhe kuadri ligjor dhe rregullator për Auditimin e Brendshëm.**

Njesia e Auditimit të brendshëm të Bashkise Berat është e organizuar në baze Sektori.

Numri i audituesve është 3 (tre) nga të cilët 1 (një) Përgj Sektori e 2 (dy) auditues.

Sektorin e auditimit të brendshëm ushtron aktivitetin e saj në zbatim të:

- Ligji nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vetvendore”
- Ligji Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik ”
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Metodologjinë e auditimit financiar , miratuar me VKM Nr. 806, datë 06.12.2006, “Për miratimin e Metodologjise së Auditimit Financiar”;
- Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdherin nr 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualin të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”,
- Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdherin nr 86, datë 10.12.2015 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”
- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikat Profesionale të publikuara nga IIA (Instituti i Auditoreve të Brendshëm) përbëjnë bazën e paketës ndërkombëtare të zbatueshme për auditimin e brendshëm .
- Kartën e Auditimit të Brendshëm të NJAB;
- Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të NJAB;

dhe akteve të tjera ligjore e nenligjore me synimin e vetëm për rritje ekonomike, angazhim dhe cilësi maksimale në shërbimet publike të ofruara

Stafi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm I Bashkise Berat për periudhën 2021-2023 ka planifikuar nevojat për trajnime sipas sistemeve dhe fushave të auditimit.

Planifikimi i realizimit të auditimit, miratimi i programeve të angazhimit dhe kontrolli i cilësisë bëhet nga përgjegjësi i grupit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Duke pasur parasysh numrin e madh të njësive me problematika nga më të ndryshmet kemi përcaktuar dhe risqet e auditimit sipas gjithë njësive dhe sistemeve.

Numri i audituesve për të audituar çdo vit është njësi që paraqesin rrezik të lartë është i vogël (gjithsej 3 auditues duke përfshirë dhe përgjegjësin e Sektorit të Auditimit. (Nga 15 Marsi 2020 e deri më sot, sektori i auditimit nga është me 2 punonjës auditues), për shkak të largimit të një audituese që nuk është zëvendësuar.

Per te mbuluar dhe keto njesi se dhe te gjitha drejtorite qe ka ne varesi bashkia Berat sipas pasqyreave nr 1 si dhe duke ruajtur frekuencen e auditimit sipas risqeve eshte e domosdoshme qe numri i audituesve ne Bashkine Berat duhet minimalisht te rritet duke kaluar ne 4 auditues , duke krijuar 2 grupe auditimi.

Argumentimi më i saktë për domosdoshmërinë e shtimit të një audituesi është bërë në Programin e Auditimit të Brendshëm të Bashkise Berat për v. 2021 bashkëlidhur evidencave.

Grupi i Auditit realizon detyrat perkatese te pershkruara ne rregulloren e Sektorit te Auditimit dhe programit te Auditit te miratuar ne fillim te vitit , auditon dhe pergatit materialet perkatese , p/raportet, raportet e auditimit dhe memorandumit me te cilin behet me dije ne te gjitha fazat dhe Titullari i Bashkise Berat.

Me ndarjen e re territoriale eshte rritur numri i njesive shpenzuese ndermarrjeve dhe drejtorive qe perdorin fonde te buxhetit te saj te miratuara me Vendim te Keshillit Bashkiak

Sektori i Auditimit te Brendshem eshte pjese e strukture organizative te Administrates se Bashkise me vartesi direkte te Titullari te Institucionit .

- **Disa nga objektivat e Auditimit te Brendshem per periudhen 2021 – 2023 jane:**

- ✓ Të ndihmojë menaxhimin e Bashkise-se,në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet qe ofron ky institucion.

- ✓ Të japë siguri objektive tek menaxhimi i Bashkise-se mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e subjekteve.

- ✓ Kryerja e veprimtarise se pavarur objektive dhe te bazuar ne identifikimin, vleresimin dhe menaxhimin e riskut.

- ✓ Dhenien e sigurise objektive per menaxhimin ne lidhje me funksionimin e sistemit te kontrollit te brendshem ne njesite qe do te auditohen.

- ✓ Te respektoje ne cdo rast e rrethane, gjate kryerjes se detyres, kodin etiko moral te nepunesit civil dhe kodin etiko- moral te audituesit per te treguar nje sjellje dhe qendrim profesional ne lartesine e duhur.

- ✓ Të ndihmojë menaxheret e njesive shpenzuese për të qenë të përgjegjshëm ndaj detyrimeve ligjore, publikut, duke vlerësuar pershtatshmerine dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave dhe kontrolleve, perputhshmerine e akteve te brendeshme, rregulloreve, urdhrave me legjislacionin perkates.

- ✓ Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim , abuzim dhe keq perdorim te fondeve.

- ✓ Të ndikojë dhe ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e rregullave, kontrolleve të vendosura.

- **Identifikimi i subjekteve per auditim:**

Duke njohur gjithe strukturen e Bashkise, kemi identifikuar 28 njesi, drejtori dhe Inspektoriate te cilat do te jene objekt i auditimit.

Per secilen organizate kemi identifikuar riskun e auditimit (shif pasqyren nr 1), si dhe kemi percaktuar fushat e auditimit per te gjitha njesite qe do te auditohen per vitin 2021 – deri me v. 2023, ku per baze kemi marre vleresimin e riskut si per mjedisin e pergjithshem dhe rikun per fusha te vecanta te auditimit brenda cdo njesie qe do te auditohet.

- **Identifikimi i fushave / sistemeve prioritare.**

Krahas subjekteve per auditim kemi percaktuar fushat apo sistemet ku do te auditojme, per nje plan auditimi sa me efektiv dhe cilesor orientimi kryesor i Njesise se Auditit te Brendshem eshte:

Konkretisht fushat apo sistemet qe paraqesin dhe risk me te larte jane,sistemi i te ardhurave, sistemi i kontabilitetit dhe i prokurimeve per nje menaxhim sa me te mire te fondeve publike qe perben prioritetin tone per vitet ne vazhdim.

- **Identifikimi dhe vleresimi i risqeve.**

Plani Strategjik i veprimtarise se sektorit te Auditimit te brendshem eshte bazuar ne identifikimin dhe vleresimin e risqeve per te gjitha njesite qe jane objekt auditimi.

Ne baze te riskut ne vitin e pare kryesisht kemi parashikuar per auditim ato njesi qe kane risk te larte dhe njesite e tjera qe kane risk te mesem si dhe me pak ato te ulet per aresye te numrit te pakte te audituesve si dhe duke zbatuar manualin e auditimit ne lidhje me frekuencen e auditimeve ku njesite me risk te larte mundesisht te auditohen cdo vite, njesite me risk te mesem ne cdo 2(dy) ose 3 (tre) vjete dhe njesite me risk te ulet minimalisht 1 here ne 5 vjete.

- **Kufizimet e Auditimit.**

Numri i pakte iaudituesve gjithsej tre vete ku perfshire dhe pergjegjesi i sektorit te auditimit eshte i pakte per te respektuar frekuencen e auditimit te pershkruar me siper. (Nga 15 Marsi 2020 e deri me sot sektori I auditimit eshte me 2 punonjes auditues), per shkak te largimit te nje audituese qe nuk eshte zevendesuar.

Per te mbuluar dhe keto njesi se dhe te gjitha drejtorite qe ka ne varesi Bashkia Berat sipas pasqyres nr 1, eshte e domosdoshme qe numri i audituesve ne Bashkine Berat duhet minimalisht te rritet duke kaluar ne 4 auditues , duke krijuar minimalisht 2 grupe auditimi.

Argumentimi me isakte per domosdoshmerine e shtimit te nje audituesi eshte bere ne Programin e Auditimit te Brendshem te Bashkise Berat per v. 2021 bashkalidhur evidencave.

- **Prioritetet per vitet 2021-2023.**

Ne punen e vete auditit i bashkise ka ushtruar me korektesi funksionet dhe kopetencat qe i jep ligji nr 114,date 22.10.2015”Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik” dhe Manualin e Auditimit te Brendshem si dhe standartet nderkombetare per audituesit e brendshem .

Detyre per ne, krahas punes se mire te auditimeve ngelet permiresimi i vazhdueshem i standateve te auditimit ne evidentimin e kohes se punes , pergatitjen e pasqyrave dhe kontrolli i cilesise se materialeve , kostoja e auditimeve dhe mbulimi me frekuenca.

Ritja e cilesise se auditimeve dhe aplikimi standarteve ngelet synimi jone ne te ardhmen.

II. STRUKTURA E PLANIT VJETOR TE AUDITIMEVE PER V.2021

- **Zhvillimet aktuale te Njesise se Auditimit.**

Njesia e Auditimit te brendshem te Bashkise Berat eshte e organizuar ne baze Sektori.

Numri i audituesve eshte 3 (tre) nga te cilet 1 (nje) Pergj Sektori e 2 (dy) auditues. Nga 15 Marsi 2020 e deri me sot sektori i auditimit eshte me 2 punonjes auditues, per shkak te largimit te nje audituese qe nuk eshte zevendesuar.

Sektori i auditimit te brendshem ushtron aktivitetin e saj ne zbatim te Ligjit nr 139/2015 “Per veteqeverisjen vetvendore”,Ligjit Nr. 114/2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik ”dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore me synimin e vetem per rritje ekonomike, angazhim dhe cilesi maksimale ne sherbimet publike te ofruara.

- **Prioritetet e auditimit per v. 2021**

Per vitin 2021 kemi percaktuar te gjitha subjektet qe do te auditojme mbeshtetur ne risqet e konstatuara gjate auditimeve te meparshme si dhe nga auditimi ifundit te cilat ndodhen ne dosjen e perhereshme per cdo njesi qe auditojme.

-kemi identifikuar fushat dhe sistemet per cdo njesi qe do te auditojme.

- kemi identifikuar periudhen e fundit te auditimit per cdo subjekt angazhimi daten e fillimit dhe perfundimit te angazhimit.

- Objektivat kryesore per v. 2021.

- Të japë siguri objektive tek menaxhimi i Bashkise-se mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e subjekteve.

- Kryerja e veprimtarise se pavarur objektive dhe te bazuar ne identifikimin, vleresimin dhe menaxhimin e riskut.

- Dhenien e sigurise objektive per menaxhimin ne lidhje me funksionimin e sistemit te kontrollit te brendshem ne njesite qe do te auditohen.

- Te respektoje ne cdo rast e rrethane, gjate kryerjes se detyres, kodin etiko moral te nepunesit civil dhe kodin etiko- moral te audituesit per te treguar nje sjeiije dhe qendrim profesional ne lartesine e duhur.

- Të ndihmojë menaxheret e njesive shpenzuese për të qenë të përgjegjshëm ndaj detyrimeve ligjore, publikut, duke vlerësuar pershtatshmerine dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave dhe kontroleve, perputhshmerine e akteve te brendeshme, rregulloreve, urdhrave me legjislacionin perkates.

- Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim , abuzim dhe keq perdorim te fondeve.

- Të ndikoje dhe ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e rregullave, kontroleve të vendosura.

• **Programi i Angazhimeve te Auditimeve per Vitin 2021 dhe i burimeve.**

Kemi planifikuar per auditim, 9 subjekte nga te cilat 5 subjekte jane me risk te larte dhe 3 subjekte me risk te ulet dhe 1 subjekt me risk te ulet. (pasqyra nr 2).

Kemi percaktur numrin e personave qe do te kryejne auditimin e na baze te tyre problematikave e risqeve kemi percaktuar dite pune per cdo auditim. Konkretisht auditimet e programuara per vitin 2021 jane si me poshte:

Nr	Njesite shpenzuese dhe subjektet qe do te auditohen.	Periudha e fundit qe jane audituar	Data qe do te filloje angazhimi	Data qe do te mbaroje angazhimi	Personat qe kryejne angazhimin	Dite.pun x.nr.audit
1-	Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve.	Drejtori e Re	08.01.2021	30.01.2021	3	51
2-	Zbatimi i Rekomandimeve te Auditimeve te kryera per Njesite e Drejtorite.	Auditimet e fundit te KLSH-se dhe Auditit.	17.02.2021	18.03.2021	3	69
3-	SH.A Ujesjelles Kanalizime.	31 Dhjetor 2016	01.04.2021	23.04.2021	3	48
4-	Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe te ardhurave.	Viti 2019	08.05.2021	231.05.2021	2	34
5-	Ndermarja e Sherbimeve Publike	30 Qershor 2019	12.06.2021	06.07.2021	3	51

6-	Drejtoria e te Ardhurave, Bashkia Berat	31Dhjetor 2018	15.07.2021	16.08.2021	2	48
7-	Njesia Administrative Otllak	31Dhjetor 2018	25.08.2021	14.09.2021	2	30
8-	Drejtoria e Bujqesise,Administrimit te Pyjeve,Ujerave dhe Veterinarise	30 Qershor 2019	30.09.2021	24.10.2021	3	66
9-	Qendra Rezidenciale” Une jam si Ju”	28 Shkurt 2019	15.11.2021	13.12.2021	3	63
I	Shuma Totale Dite Njerez					460
II	Pergatitja dhe evadimi i materialeve te auditimit					150
III	Pergatitja me legjislacionin e ri etj per audituesit (1 dite ne 2 jave x 3)	3x26				78
IV	Pergatitja e planeve te punes mujore, vjetore, strategjike, informacioneve mujore etj, evidencave e kontrolli i cilesise etj te pergj.sektorit.	1	60			40
V	Te tjera (programime nga lart)					28
	Shuma Totale Dite Njerez					756

Per grup prej 3 vetash burimet e mundshme per cdo vite mund te jene 203 dite te mundshme ne vite x 3 auditues = 609 dite ne total, si me poshte:

- Koha maksimale e vlefshme ne vite per person 52 jave x 5 dite = 260 dite pune ne vite.
- Pushime vjetore = 20 “ “
- Festat = 14 dite pune ne vite.
- Semundjet = 5 “ “
- Trajnimet = 10 “ “
- Takime ne grup = 4 takime ne vite.
- Ndhurma emergjente = 4 dite ne vite.
- **Totali i burime per nje auditues mundshme. = 203 dite te**

Totali i burimeve te mundshme per 3 audituesit 203 x 3= 609 dite pune.

Nga perlllogaritja e mesiperme rezulton se per te realizuar programin e mesiperm ne kushte normale duhet duhet te shtohet numri i audituesve minimalisht me 1 person. (756 : 203 dite te mundshme/person = **3.75 auditues**).

Programi do te realizohet duke patur nje intesitet me te madh per te ruajtur frekuencen e auditimeve.

Gjithe veprimtaria e auditimit e sektorit tone i eshte permbajtur gjithe fazave te auditimit te percaktuara si me poshte:

Faza e pare, ka te beje me njohjen e organizates qe do te auditohet , ku perfshihet njohja e mjedisit ku ajo vepron, risqet kryesore qe asaj i kanosen e qe jane elemente kryesor mbi te cilat hartojme planin strategjik .

Faza e dyte, ka te beje me identifikimin e sistemeve dhe fushave te veprimtarise, e cila na jep mundesi qe sipas llojit te organizates te bejme klasifikimin e sistemeve ,per te tre menytrat funksionale , te strukturimit ose e kombinuar.

Faza e trete, ka te beje me konsolidimin e punes se planifikimit per organizaten qe do te auditohet. Duke studiuar elementet e riskut percaktojme me qarte dhe ne menyre te sakte nje plan auditimi ne perputhje me objektivat e organizates avantazhet dhe dizavantazhet , te cilat merren gjithmone parasysh ne gjykimin tone.

Faza e katert, ka te beje me perlllogaritjen e burimeve njerezore dhe financiare te auditimit, te cilat duhet te jene disponibel ne menyre te perhereshme.

Faza e peste eshte hartimi i programit te AB

Mbi bazen e te dhenave te grumbulluara dhe duke krijuar nje njohje te sakte te organizatave dhe veprimtarise se tyre , fushat dhe mundesite e shfaqjes se riskut kemi hartuar Planit Strategjik per periudhen 2021- 2023, i cili eshte miratuar nga Kryetari i Bashkise

- **Kostua e auditimit.**

Per te gjithe punen e kryer te auditimit si dhe pergatitjen e materialeve, dhenien e rekomandimeve dhe masave perkatese ne permiresimin e punes per miremenaxhimin e njesive , rezulton nje kosto vjetore prej 3.190 mije leke , ose kosto mesatare vjetore per nje punonjes eshte 1.063 mije leke. Ne pasqyren nr 5 kemi pasqyruar shpenzimet e pagave bruto te punonjesve, sigurimet shoqerore e shendetsore e shpenzimet per udhetim e dieta per te tre punonjesit e auditimit te brendshem publik.

- **Planifikimi i nevojave te stafit per trajnim.**

Per v. 2021 kemi identifikuar nevojat per trajnim si me poshte:

1. Vleresimi i regjistrit te riskut per nje njesi te audituar.
2. Prokurimi publik me mjete elektronike, per 3 persona dite gjithsej 3
3. Planifikimi i angazhimit te auditimit per njesite.
4. Kontrolli i cilesise se auditimit.
5. Analiza e riskut gjate hartimit te planit strategjik.

Per te gjitha trajnimet jane programuar te trajnohen 3 auditues per 5 dite gjithsej 15 dite sipas ligjit te auditimit te brendshem (trajtuara ne pasqyren nr 4).

- **Sigurimi i brendshem i cilesise.**

Ne zbatim te pikes 7.1 te Manualit te Auditimit te Brendshem me Urdherin e Kryetarit te Bashkise Berat Nr 166,date 26.02.2019 eshte miratuar program i sigurimit te brendshem te cilesise se sektorit te Auditit te brendshem.

Qellimi i programit është që të përcaktojë nëse procedurat e auditimit të brendshëm janë zbatuar në përputhje me standartet e auditimit dhe janë zbatuar të gjitha fazat, sipas program të miratuar të auditimit.

Rishikimi i punës audituese kryhet në çdo fazë dhe lihet gjurmë për çdo njësi të audituar.

Si e mëtejshme evidentohet fakti se në shumë auditime përgjegjësi i auditimit është dhe vete auditues.

IV. Objektivi i rritjes së cilësive të auditimeve dhe aplikimi i standarteve.

Në punën e vete auditit i bashkëpunues ka ushtruar me korektesi funksionet dhe kompetencat që i jep ligji nr 114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm si dhe standartet ndërkombëtare për audituesit e brendshëm.

Detyrë për ne, krahas punës së mirë të auditimeve ngelet përmirësimi i vazhdueshëm i standardeve të auditimit në evidentimin e kohës së punës, përgatitjen e pasqyrave dhe kontrolli i cilësive të materialeve, kostoja të auditimeve dhe mbulimi me frekuenca.

Ritja e cilësive të auditimeve dhe aplikimi i standarteve ngelet synimi i jone në të ardhmen.

Në detyrim të ligjit nr 114 /2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" Sektori ynë i auditimit dorëzon pasqyrat e miratuara të planit strategjik dhe vjetor të cilat japin një informacion më të hollësishëm mbi njësitë që do të auditohen dhe listimin e njësive për auditim gjatë vitit 2020-2022.

Bashkelidhur formatet e miratuara;

Formati nr 1, "Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që do të auditohen.

Formati nr 2, "Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2021-2023"

Formati nr 3, "Plani i angazhimeve të subjekteve për auditim për vitin 2021".

Formati nr 4, "Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2021".

Formati nr 5 "Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për Vitin 2021"

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm
Xhevahir MUZHAKA